



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1040 Prot.

Tiranë, më datë 24.08.2022

VENDIM

Nr. 436, datë 24.08.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, VKM-së Nr.427, datë 20.06.2012 “Për shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Krujës dhe miratimin e rregullores së administrimit”, nenit 113 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, pas rishikimit të Vendimit të KKTKM-së Nr. 382, datë 07.07.2022 mbi aplikimin “Restaurim adaptim i banesës 2 kate në strukturë akomoduese BB”, Brenda kufirit Zona arkeologjike “A” Krujë, me aplikues Piro Karanxha dhe zhvillues Fatos Hoxha, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.08.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërhyrjeve adaptuese, përmirësuese mbi aplikimin e sipërcituar konform vërtetimit të dokumentit hipotekor të pronës, pozicionuar brenda zonës arkeologjike “A”, të qytetit të Krujës.
2. Monitorimin nga DRTK Tiranë, për çdo ndërhyrje, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Rudina ZOTO

